UDHËZIM
Nr.5688/1, datë 12.10.2010

PËR ZBATIMIN E MASAVE TË PËRBASHKËTA NË DISIPLINIMIN E SHËRBIMIT TAKSI TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 7 dhe 46 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar, të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, të ligjit nr.8224, datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës", të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJMË:

1. Policia e Shtetit të intensifikojë masat në drejtim të rritjes së sigurisë në rrugë, parandalimit të aksidenteve dhe krijimit të kushteve për një lëvizje e qarkullim pa pengesa të mjeteve e këmbësorëve në zonat urbane dhe rurale.

2. Strukturat vendore të Policisë së Shtetit, në përmbushje të detyrimeve, sipas nenit 46 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", të marrin të gjitha masat për të qenë menjëherë në mbështetje të organeve të kontrollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe organeve të qeverisjes vendore, në çdo rast kur kjo kërkohet nga ana e tyre, në ekzekutimin e vendimeve për kundërvajtjet administrative të konstatuara nga këto organe.

3. Organet e kontrollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor të bashkëpunojnë me organet vendore të Policisë së Shtetit dhe organet e qeverisjes vendore për evidentimin e mjeteve të pajisura me licencë, si dhe të pajisjes së drejtuesve të këtyre mjeteve me dëshminë përkatëse të aftësisë profesionale.

4. Organet e kontrollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor të bashkëpunojnë me organet e qeverisjes vendore për njoftimin e publikut, në median elektronike dhe të shkruar, lidhur me kriteret e funksionimit të shërbimit taksi, organet e kontrollit, kompetencat, si dhe sanksionet ligjore për shkeljet.

5. Strukturat vendore të Policisë së Shtetit, organet e kontrollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor të bashkërendojnë punën me organet e qeverisjes vendore për koordinimin e masave në identifikimin e mjeteve dhe drejtuesve të tyre që merren me kryerjen abuzive të shërbimit taksi, vendqendrimet përkatëse dhe mbajtjen e tyre në kontroll, gjatë gjithë kohës.

6. Ngarkohen strukturat e Policisë së Shtetit, organet e kontrollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, si dhe organet e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Lulzim Basha

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi